



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.465/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret; Arsim Hamzaj - kryesues, Kimete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje me (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë;09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.465/2025, e datës 08.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

#### A r s y e t i m

Me datë 08.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e (LDK), ushtron ankesë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendohet se LDK Dega ne Podujeve ka vërejtur se Komuna e Podujevës ka shkelur nenin 36 paragrafi 2 me rastin e vendosjes në përdorim të Ndërmarrjes Publike Lokale "EKO-LLAPI" Sh. A, për largimin e banerit të Lëvizjes Vetëvendosjes në qendër te Podujevës, ne Sheshin "4 Dëshmoret"

Mëtutje pretendojnë se është vënë një funksion një ndërmarrje publike lokale-asetet e saja respektivisht kamioni me kran për të larguar banerët e subjektit politik LVV-Dega ne Podujeve.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
Anr.465/2025, datë 11.02.2025



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.